L I G J
Nr.8020, datë 1.11.1995

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7599, DATË 2.9.1992 "KODI DOGANOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7599, datë 2.9.1992 "Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë", neni 3 ndryshohet si vijon:

"Me organe doganore për efekt të zbatimit të këtij Kodi, sipas rastit, kuptohet: Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, kryetarët e degëve në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, drejtorët e drejtorive rajonale, inspektorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe të drejtorive rajonale, kryetarët e degëve doganore, doganierët, oficerët dhe nënoficerët e policisë doganore".

Neni 2

Në nenin 13 shtohet paragrafi i dytë si vijon:

"Për armatimet, teknikën dhe pajisjet luftarake, format dhe mënyrat e deklarimit të tyre në doganë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave".

Neni 3

Në nenin 32 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si vijon:

"Ç'do drejtues mjeti që transporton mallra, sapo mbërrin në zonën doganore, u dorëzon autoriteteve doganore, si deklaratë përmbledhëse, një dokument të transportit rrugor (CMR, CARNET, TIR) ku pasqyrohen mallrat që ai transporton. Ai është përgjegjës para ligjit për çfarëdo rasti të shkeljeve të kërkesave të parashikuara në marrëveshjet ndërkombëtare doganore për transportet me anën e CARNET, TIR dhe CMR".

2. Shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"Drejtuesit të mjetit i ndalohet të shmaget nga rruga e përcaktuar nga dogana kufitare. Ai duhet të paraqitet në doganën e destinacionit brenda afateve".

Neni 4

Neni 59 ndryshohet si vijon:

"Drejtori i Përgjithshëm i Doganave ose kryetari i degës doganore, për detyrimet doganore dhe ato të dënimit me gjobë që nuk paguhen brenda afateve të caktuara, vendosin për sekuestrimin e vlerave materiale e monetare të subjekteve debitore në masën e detyrimit, duke përfshirë edhe kamatvonesën të përcaktuar me ligj. Urdhri i organeve doganore për detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i këtij kodi, është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga policia doganore.

Për subjektet juridike dhe fizike që kanë llogari rrjedhëse në bankë, zbatimi i titujve ekzekutivë bëhet nga bankat përkatëse, në lekë ose në valutë.

Me përfundimin e afatit ligjor të qëndrimit të mallrave në magazinë, në zonën doganore ose nën një regjim të ndërmjetëm, pas një muaji ato shiten nga organi doganor".

Neni 5

Në nenin 62 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4 ndryshohet si vijon:

“Gjetja e mallrave të padeklaruar ose mospërputhja ndërmjet dokumenteve shoqëruese të mallit me gjendjen faktike të tij në sasinë, cilësinë dhe llojin e tyre, kur për vetë rrethanat që kanë të bëjnë me çështjen, prokuroria vendos për mosfillimin e çështjes penale ose pushimin e saj për mungesë të elementeve të veprës penale”.

2. Pika 5 ndryshohet si vijon:

“Kundërshtimi i doganierit, punonjësit të policisë doganore, pengimi ose vonimi i tyre në ushtrimin e detyrës që u njihet me ligj”.

3. Shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:

9. “Moskryerja e detyrës nga doganieri ose nga punonjësi i policisë doganore ose kryerja e saj në kundërshtim me legjislacionin doganor dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, kur veprimet dhe mosveprimet e tyre nuk përbëjnë vepër penale”.

Neni 6

Në nenin 63, shtohen pikat 10 e 11 me këtë përmbajtje:

10. “Mosparaqitja në doganën e destinacionit për t’iu shmangur kontrollit doganor”.

11. “Shkarkimi apo ngarkimi i mallit nga drejtuesi i mjetit të transportit, pronarit ose përfaqësuesit të tij pa lejen me shkrim të doganës, apo pa qenë i pranishëm organi doganor”.

Neni 7

Pika 1 e nenit 70 ndryshohet si vijon:

“Të gjitha rastet e kundërvajtjeve të përcaktuara në nenin 62 të këtij kodi, me përjashtim të pikës 4, si dhe rastet e tjera të shkeljes së dispozitave ligjore e nënligjore, të cilat nuk përbëjnë kontrabandë ose ndonjë vepër tjetër penale, dënohen nga organet doganore me gjobë nga 20 000 deri në 500 000 lekë dhe me sekuestrimin e pjesshëm a të plotë të mallit objekt kundërvajtjeje.

Për kundërvajtjet e parashikuara në pikën 4 të nenit 62 të Kodit Doganor, organet doganore bëjnë sekuestrimin e plotë të mallit objekt kundërvajtje, të mjetit të transportit, si dhe vendosin gjobën sa dyfishi i detyrimit doganor.

Ministri i Financave cakton kriteret më të detajuara për masën e gjobës sipas llojit të kundërvajtjes dhe vlerës së mallit kundërvajtës”.

Neni 8

Paragrafi i katërt i nenit 72 ndryshohet si vijon:

“Kur personi i interesuar nuk është i një mendimi me vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, brenda 5 ditëve mund të bëjë ankesë në organet gjyqësore”.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1280, datë 15.11.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha